




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI"-PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI"-PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI"-PRISHTINA

Mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Udhëzimit administrativ nr. 01/2018 të MASHT për "Parimet e njohjes se platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension" dhe Udhëzimit Administrativ 7/2018 të MASHT për "Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi-I- MASHT) e UA 01/2018 për "Parimet e Njohjes se Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension", Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë "Ali Hadri", në mbledhjen e datës 20.06.2024, miratoi:

## RREGULLORE

PËR PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01.50/20 E DATËS 12.03.2020  
PER PROCEDURAT E ZGJEDHJES DHE RIZGJEDHJES SË PUNËTORËVE SHKENCORË  
DHE HULUMTUESVE NË INSTITUTIN E HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË

### Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i "Rregullores nr. 01.50/20 e datës 12/03/2020 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë Ali Hadri - Prishtinë".
2. Çështjet që nuk janë të rregulluara me aktet ligjore përkatëse në fuqi, rregullohen me dispozitat vijuese të kësaj rregulloreje.

### Neni 2 Plotësim dhe ndryshim

1. Plotësohet dhe ndryshohet nenet: 7, 9, 11, 13 dhe shtojca një (1):
  - 1.1 Plotësohet dhe ndryshohet neni 7, me ç' rast shtohen nën paragrafët si vijojnë:
    - 1.4 Mandati i hulumtuesit të pavarur është 3 vjet më të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat. Përgjatimisht hulumtuesi i pavarur i cili është rizgjedhur për mandatin e dytë, mund t'i hapet konkursi për avancim në thirrjen bashkëpunëtor shkencor pa e konsumuar mandatin me rastin kur konstatohet-vlerësohet që i plotëson kriteret.
    - 1.5. Hulumtuesit nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni mund të zgjedhën në titullin e njëjtë edhe për një mandat.
    - 1.6. Në rast të rrethanave të cilat hulumtuesi i pavarur është në procedurën përfundimtare të mbrojtjes së temës së doktoratës të cilat i udhëheq Universiteti përkatës, të njëjtit do t'i vazhdohet pozita në Institut, për një periudhë dy vjeçare.

- 1.7. Huluntuesit dhe huluntuesit të pavarur do t'i caktohet një mentor nga radhët e punonjësve shkencor të Institutit, për realizimin e objektivave të tij/saj në avancimin shkencor.
- 1.2. Plotësohet neni 9, me ç'rast shtohen nën paragrafët si vijojnë:
- 9.4. Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension përcaktohen nga Ministria përkatëse për shkencë.
- 9.5 Meritokracia profesionale - shkencore e veçantë; Në shërbimit të meritokracisë profesionale dhe shkencore të veçantë, si dhe të baras vlefshmërisë së arritjeve shkencore me thirrjet e punonjësve shkencor të Institutit, punonjësi shkencor mund të parashtrojë kërkesë drejtorit/es për zgjedhje në thirrjen përkatëse të arritur, pa marrë parasysh renditjen e titujve, në momentin e arritjeve të kushteve dhe parametrave të normave ligjore të përcaktuara me këtë rregullore. Kërkesa do të shqyrtohet në formë profesionale dhe të pavarur lidhur me kushtet e arritura sipas kësaj rregulloreje, nga ana e "Komisionit recensues për meritokracinë profesionale-shkencore të veçantë" i përbërë nga tre anëtar dhe i emëruar nga drejtori/ja i Institutit, apo vendoset pavarësisht nga "Komisioni recensues për zgjedhje". Me recensionin pozitiv të "Komisionit recensues për meritokracinë profesionale-shkencore të veçantë" do të shpallet konkursi për titullin meritior. Në rastin në procedurë të rregulltë kandidati zgjedhet me miratimin e konkluzionit-recensionit të "Komisionit recensues për zgjedhje" nga Këshilli Shkencor.
- 9.6 Kushtet-kualifikimet për ngritje në thirrje, me rastin e plotësimit të parametrave shkencor, janë më se vijon:
- 9.7 Këshilltar shkencor: PHD - Doktor i Shkencave; pesë (5) punime ndërkombëtare shkencore si autor kryesor të indeksuara në platformën scopus (elsevier), web of science (clarivate), punime të indeksuara sipas rregullores së Ministrisë përgjegjëse për shkencë (që rregullon parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension) apo barasvlershëm botimi i (3) tri veprave shkencore monografike, si dhe katër (4) vëllimeve me dokumente historike në fushën përkatëse, pjesë përbërëse si autor ose grup autorësh; pesë (5) punime në revista shkencore kombëtare; pjesëmarrje në dhjetë (10) konferenca kredibile shkencore; si dhe përvojë udhëheqëse institucionale në projekte kërkimore, shkencore dhe profesionale të ndërmarra nga institucionet shkencore, akademike, profesionale, universitare dhe shtetërore.
- 9.8. Bashkëpunëtor i lartë shkencor: PHD - Doktor i Shkencave; tri (3) punime ndërkombëtare shkencore si autor kryesor të indeksuara në platformën scopus (elsevier), web of science (clarivate), punime të indeksuara sipas rregullores së Ministrisë përgjegjëse për shkencë (që rregullon parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension) apo barasvlershëm botimi i (2) dy veprave shkencore monografike, një (1) prej të cilave pas thirrjes së fundit; tri (3) vëllime me dokumente historike, pjesë përbërëse si autor ose grup autorësh; tri (3) punime në revistat kombëtare; si dhe pjesëmarrje në (5) konferenca kredibile shkencore;
- 9.9. Bashkëpunëtor shkencor: PHD - Doktor i Shkencave; (2) dy punime ndërkombëtare shkencore si autor kryesor të indeksuara në platformën scopus, web of science (clarivate), punime të indeksuara sipas rregullores së Ministrisë përkatëse për shkencë (që rregullon parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension) apo barasvlershëm botimi i (1) një veprave shkencore monografike dhe dy (2) vëllime me dokumente historike, pjesë përbërëse si autor ose grup autorësh; (2) punime në revistat kombëtare; si dhe pjesëmarrje në tri (3) konferenca kredibile shkencore.
- 9.10. Në rast të plotësimit vetëm të kushteve për botimin e punimeve ndërkombëtare, atëherë kandidati – përpos tjerave, duhet t'i plotësojë në tërësi edhe kushtet për titujt shkencor sipas

dispozitive të kësaj rregulloreje lidhur me meritokracinë profesionale - shkencore të veçantë, për botimin e veprave shkencore monografike, vëllimeve të dokumenteve historike, konferencave shkencore, punimeve dhe kushteve të tjera.

9.11. Për punonjësit shkencor të antikitetit dhe historisë së artit “Vëllimi me dokumente” është i barasvlershëm më botim të “Katalogimit të kulturës materiale dhe trashëgimisë kulturore”, eksponateve dhe fragmenteve të gjetjeve arkeologjike.

9.12. Këto kushte plotësuese vlejné vetëm për ngritje të menjëhershme sipas meritave profesionale - shkencore të veçanta në titullin respektiv shkencor, bazuar në arritje shkencore të barasvlershme.

1.3. Ndryshohet neni 11, me ç’rast hiqet paragrafi 4.

1.4. Ndryshohet neni 13, me ç’rast plotësohet paragrafi 11: “Komisioni recensues brenda afatit prej 3 ditëve pune i tërheq dosjet e konkursit. Komisioni obligohet që brenda 10 ditëve pas tërheqjes së dosjeve ta dorëzoj referatin e nënshkruar dhe të protokolluar”.

1.4. Ndryshohet dhe zëvendësohet Shtojca I, në përputhje me “Udhëzimin Administrativ 7/2018 të MASHT për “Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi-I- MASHT) e UA 01/2018 për “Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension”, më se vijon:

#### *Shtojca I*

### FORMULAR PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE, SHKENCORE DHE PROFESIONALE

A. Autori i parë, autori korrespondent dhe punimet e publikuara në revista ndërkombëtare

Në përputhje me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutin e Institutit, punimi i publikuar apo miratuar për botim në revistë ndërkombëtare shkencore mund të shfrytëzohet për nevoja të zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit nga autori i parë i punimit dhe nga autori korrespondent.

A.1. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore, vlejné përkufizimet vijuese:

- a) Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar;
- b) Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar me shume se një autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë;
- c) Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.
- d) Autori i trete i punimit apo autoret e tjerët pasues ju njihet koeficienti 0.5 pikë.

A.2. Bazuar në Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e Institutit dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të publikuara apo miratuara për botim në revista ndërkombëtare shkencore gjatë vlerësimit të kandidateve të paraqitur në konkurs vlejné punimet në fushën e kandidatit në të cilën është zgjedhur apo për të cilën konkurren, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike dhe të kategorizuara si në vijim:

A.2.1. Punimet e publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese janë të barasvlershme me 1:

1. Web of Science: Core Collection (<https://mjl.clarivate.com/home>)
2. Scopus (Elsevier) (<https://www.elsevier.com/solutions/scopus>)
3. EBSCOhost (<https://www.ebsco.com>)
4. WorldCat (<https://www.worldcat.org/>)
5. Directory of Open Access Journals (<https://doaj.org/>)

A.2.2. Punimet e publikuara në revista kombëtare dhe botime të veçanta, të cilat janë të barasvlershme me koeficient 1.

1. Kosova ([https://albanica.al/revista\\_kosova/](https://albanica.al/revista_kosova/))<sup>1</sup>
2. Studia Albanica (<https://albanica.al/studialbanica>)
3. Studime Historike (<https://ih-revista.edu.al/index.php/ih-revista>)
4. Iliria ( <https://www.persee.fr/colection/iliri>); Candavia (<https://www.qsa.edu.al>)
5. Botime të veçanta të Instituteve shkencore dhe Akademive të shkencave duke përfshirë libër të edituar me punime të veçanta dhe ato të konferencës.

A.2.3. Punimet e publikuara në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.85:

1. WorldWideScience (<https://worldwidescience.org/>)
2. Microsoft Academic Search (<https://academic.microsoft.com/home>)
3. BASE (Bielefeld Academic Search Engine) ( <https://www.base-search.net/>)

A.2.4. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.70:

1. Hrvatska znanstvena bibliografija (<https://bib.irb.hr/>)
2. ULAKBIM - National Academic Network and Information Center (<https://cabim.ulakbim.gov.tr/tr-dizi%20n/tr-dizinde-dizinlenen-dergi-listesi>)
3. CAB Direct(<https://www.cabdirect.org/cabdirect/>)
4. ProQuest(<https://www.proquest.com/libraries/academic/>)
5. Open akademik Journals Index (<http://oaji.net/>)
6. JSTOR (<https://www.jstor.org/>)

A.2.5. Punimet e publikuara në revista vijuese barasvlerësohen me 0.55:

1. Studime shoqërore (<http://www.ashak.org/?cid=1,31>)
2. Gjurmime Albanologjike (<http://CEEOL>)

A.2.6. Pjesëmarrja në Konferencë shkencore të organizuar nga institucioni publik kërkimor-shkencor është i barasvlershëm me 0.30; Pjesëmarrja fizike me kumtesë në Konferencë kredibile shkencore ndërkombëtare dhe e organizuar nga një Institucion ndërkombëtar me renome, është i barasvlershëm me 1 punim ndërkombëtar.

---

<sup>1</sup> Artikujt shkencorë të botuar në revistën e Institutit të Historisë "Ali Hadri", do të barasvlerësohen me 1 punim.

A.2.7. Monografia - vëllimi me dokumente i botuar / ISBN nga institucioni apo shtëpia botuese e regjistruar e kredibile dhe me recension profesional, duhet t'i nënshtrohet miratimit formal të "Komisionit recensues për zgjedhje" të Institutit, për vlerësimin e veprës historike dhe rëndësisë për historiografinë e Kosovës.

Tabela 1.1 Publikimet në revista, botime dhe konferenca që plotësojnë kushtet si në paragrafët A2.1, A2.2. dhe A2.6.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista/Bot./Kon.	Vëll., nr., (viti), faqet	Linku i publikimit <sup>2</sup>
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.2 Publikimet në revista, botime dhe konferenca që plotësojnë kushtet si në paragrafët A.2.3, A.2.4 dhe A2.5

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista/Bot./Kon.	Vëll., nr., (viti), faqet

### Neni 3

#### Dispozita plotësuese dhe shfuqizuese

- Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje "Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 01.50/20 të datës 12/03/2020 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri", plotësohen dhe ndryshohen nenet: 7.1.4 - 7.1.6; 9.4-9.12; 11.4; si dhe shtojca një (1):

<sup>2</sup> Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun, nëpërmjet të cilit dëshmohet indeksimi i punimit, përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse të paragrafit A2.1-A2.4.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë.

Drejtor  
Prof. dr. Teuta Shala Peli

